

Njoftim për studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë Fakulteteve të Drejtësisë !

Në zbatim të nenit 16 pika 2 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku përcaktohet se: “*Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore*”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 9 Institucione të Arsimit të Lartë sipas tabelës së poshtëshënuar.

Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë	Data e lidhjes së marrëveshjes	Koordinatori i Klinikës së Ligjit	E-mail
1	Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë	20 Shkurt 2020	Zj. Oriona Mucollari (Klinika Dep. Publik) Zj. Petrina Broka (Klinika Dep. Civil)	tildamia@yahoo.it petrina.broka@fdut.edu.al
2	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Bedër	13 Maj 2020	Z. Nertil Bërdufi	nberdufi@beder.edu.al
3	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Wisdom	20 Maj 2020	Z. Alban Duraj	albaniduraj@yahoo.com
4	Marrëveshje Bashkëpunimi me UET	4 Qershor 2020	Z. Ilir Korbi	ilir.korbi@uet.edu.al
5	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës	16 Qershor 2020	Z. Andon Kume	andon.kume@gmail.com
6	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ismail Qemali Vlorë	13 Qershor 2020	Z. Ertit Mecaj	ertil.mecaj@univlora.edu.al
7	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Qiriaz	30 Shtator 2020	Zj. Sonila Kamani	sonilakamani@gmail.com
8	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar	24 Nëntor 2020	Zj. Fiona Tako	fionatako@umsh.edu.al

9	Marreëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër)	3 Nëntor 2020	Zj. Griselda Dama	griseldadama@gmail.com
10	Marreveshje Bashkëpunimi me Universitetin Barleti	21 Janar 2021	Z. Elona Bano	law.co@umb.edu.al

Sa më sipër, ftojmë studentët që janë duke ndjekur studimet në drejtësi pranë këtyre Fakulteteve që të angazhohen pranë Klinikave të Ligjit me qëllim përfitimin e njohurive praktike pranë këtyre Klinikave si dhe angazhimin e tyre në kuadër të:

- Pjesëmarrjes në webinare/trajnime të zhvilluara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mbi ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (*pajisje me vërtetimin përkatës*);
- Pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese/edukimin ligjor që publikut të planifikuara për t'u zhvilluar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2021;
- Zhvillimit të praktikave 3 mujore të punës pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron¹(*pajisje me vërtetimin përkatës*);
- Zhvillimit të praktikave të punës pranë Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore (*pajisje me vërtetimin përkatës*).

Studentët e interesuar duhet të përcjellin kërkesën e tyre si dhe një letër motivimi brenda datës 26 Janar 2020, në adresën zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (dnjf@drejtesia.gov.al) si dhe në adresën e Pedagogut Koordinator të Klinikës (sipas tabelës bashkëlidhur).

¹ Sipas një grafiku të miratuar pas përzgjedhjes së praktikantëve nga Koordinatorët e Klinikave të Ligjit.

